

6.1 LLAÇRA PËR SUVATIME

MORTEL GP-10 FAST



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 100 Kg/Rifuxho	54 cp/paletë Sillos	1,5 Kg/m ² /mm --	Gri --



Mortel GP - 10 Fast

Material mbushës me tharje të shpejtë për mure tulle ose blloku për ambiente te brendshme ose të jashtme.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Material në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rëre guri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditiv special.
- Karakterizohet nga një punueshmëri mjaft e mirë.
- Rezistencë të lartë mekanike
- Pa rrëshqitshmëri vertikale
- Aftësi ngjitëse në mure dhe tavane.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret si llaç themelor për suvatimin e të gjitha llojeve të suporteve si mureve prej tulle, blloqe etj. Produkti aplikohet me dorë. Gjatë aplikimit të produktit temperatura e suportit dhe temperatura e ambientit duhet të jenë nga +5°C deri në +35°C.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suporti ku do të aplikohet materiali duhet të jetë i thatë, i pastër, i njëtrajtshëm, absorbues, i qëndrueshëm. Nuk duhet të ketë mbetje të huaja si vajra, verniqe, nafta, etj. Suporti mbi të cilin aplikohet materiali nuk duhet të ketë shfaqje dukurish të tilla si efluoreshenca.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përziemi 25 Kg pluhur Llaç Mbushës me 5 - 5.5 litra ujë me anë të një përzierësi elektrik ose në mënyrë manuale, derisa të fitohet një masë për punueshmërinë e kërkuar.

MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Produkti aplikohet në mënyrë manuale, me mistri. Mos e përziemi me materiale të tjera përveç LATEX. Llaçi i freskët duhet përpunuar brenda 1 orë. Mbroni tullat dhe llaçin (mbi të gjitha gjatë ndërprerjes së punës) nga shiu. Në rast se temperaturat janë të larta mirë është që llaçi të laget pak përpara se të thahet në mënyrë që të mos humbasë ujin.

PËRFORCIMI ME LATEX

Për ti përmirësuar ngjitshmërinë, papërshkueshmërinë nga uji, plasticitetin, elasticitetin, forcën mekanike etj, llaçi mund të përforcohet me adetivin LATEX. Raporti i përzierjes është 1:5 në ujë. (shikoni skedën teknike LATEX)



TË DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Ruajtja	12 muaj në paketim origjinal në vënd të thate
Djegshmëria	I padjegshëm
Raporti i përzierjes	5-5.5 litra ujë për 25 kg llaç muraturë
Dëndësia e përzierjes	1.9 gr/cm ³
Konsistenca e Përzierjes	Tiksotropike
Temperatura e aplikimit	+5°C deri në +35°C
Kohëzgjatja e përzierjes	3-4 orë
Koha e punueshmërisë	2 orë
Trashësia maximale për dorë	1.5 cm
Fillimi i ngurtësimit	385 min

